

Fondacioni Rural Credit Guarantee

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe për
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

PËRMBAJTJA

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	
Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor, 2019	6
Pasqyra e të Ardhurave dhe Fondeve të Pashpërndara më 31 dhjetor, 2019	7
Pasqyra e Ndryshimeve në Fond më 31 dhjetor, 2019	8
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë më 31 dhjetor, 2019	9
Shënime mbi Pasqyrat Financiare	10 – 32

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Drejtimit të Fondacionit Rural Credit Guarantee

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të "Rural Credit Guarantee" ("Fondacioni"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019 dhe pasqyrën e të ardhurave dhe fondeve të pashpërndara, pasqyrën e ndryshimeve në fond dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondacionit më datë 31 dhjetor 2019 si edhe të performancës së saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "*Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare*" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen me anë të shënimit shpjegues 25 në pasqyrat financiare ku përshkruhet vlerësimi i Drejtimit për ndikimin aktual ose të mundshëm të efekteve të koronavirusit COVID-19 në Fondacion. Opinioni ynë nuk është i modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për të dhëna të tjera. Të dhënat e tjera përmbajnë informacionin e dhënë në Raportin e Aktivitetit të Performancës, të përgatitur nga drejtimi në përputhje me nenin 22 të Ligjit, Nr. 25/2018, datë 19 janar 2019 "Të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare", i ndryshuar, por nuk përfshin në të Pasqyrat Financiare dhe Raportin tonë të Auditimit. Raporti i Aktivitetit të Performancës pritet të vihet në dispozicion pas datës së këtij Raporti Auditimi. Opinioni ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin pjesën e të dhenave të tjera dhe ne nuk shprehim asnjë konkluzion që jep siguri në lidhje me këto të dhëna.

Informacione të tjera (vazhdim)

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë të dhënat e tjera të identifikuara më lart, kur këto të dhëna të jenë të disponueshme dhe, duke e bërë këtë, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër nuk është material në kundërshtim me pasqyrat financiare apo njohuritë tona të marra gjatë auditimit, ose në të kundërt nëse është material. Gjatë rishikimit të Raportit të Aktivitetit të Performancës, nëse konstatojmë se ekziston një gabim material në të, nga ne kërkohet që t'ua komunikojmë çështjen drejtimin dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare.

Përgjegjësitë e drejtimin dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Fondacionit për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbledhjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhe shënimet shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë që të arrihet një paraqitje e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Fondacionit, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania shpk
Deloitte Audit Albania shpk
Rruga Faik Konica, Ndërtesa nr. 6 Hyrja nr 7,
1010, Tirana, Shqipëri
Numër unik identifikimi i subjektit (NUIS): L41709002H

DELOITTE AUDIT ALBANIA Rruga Faik Konica, Ndërtesa nr. 6 Hyrja nr 7, 1010, Tirana - ALBANIA NIPT: L 41709002 H Tel: 044517920
--

Enida Cara
Auditues ligjor

12 maj 2020

Tiranë, Shqipëri

Fondacioni Rural Credit Guarantee
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019

(Shumat në Lek)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
AKTIVET			
Aktivete afatgjata			
Aktive materiale	7	1,698,843	647,249
Aktive jomateriale	8	636,408	848,544
E drejta e përdorimit të aseteve	9	17,613,702	-
Investime të mbajtura për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale	10	3,151,406,194	209,258,314
Depozitë me afat		-	103,238,904
Parapagime		1,078,728	-
Totali i aktiveve afatgjata		3,172,433,876	313,993,011
Aktivete afatshkurtra			
Investime të mbajtura për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale	10	119,228,308	-
Llogari të arkëtueshme	11	6,175,148	1,488,372
Aktive të tjera afatshkurter		-	119,717,400
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	12	935,452,428	3,735,361,945
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,060,855,884	3,856,567,717
TOTALI I AKTIVEVE		4,233,289,760	4,170,560,728
DETYRIME DHE KAPITALI			
Kapitali			
Fondi		4,113,448,116	494,716,400
Shpenzime të akumuluar		(41,842,229)	(14,466,860)
Të ardhura/(shpenzime) neto për vitin		8,768,069	(27,375,368)
Totali i kapitalit		4,080,373,956	452,874,172
Detyrime afatgjata			
Të ardhura të shtyra	13	71,141,358	3,686,258,392
Detyrimi i qirasë	14	15,227,585	-
Totali i detyrimeve afatgjata		86,368,943	3,686,258,392
Detyrime afatshkurtra			
Të ardhura të shtyra	13	4,236,775	546,687
Detyrimi i qirasë	14	2,282,272	-
Provizione për garanci	21	58,820,953	30,349,246
Detyrime të tjera	15	1,206,860	532,231
Totali i detyrimeve afatshkurtra		66,546,860	31,428,164
TOTALI DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		4,233,289,760	4,170,560,728

Këto pasqyra financiare të Fondacionit më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 u aprovuan nga Drejtuesi i Fondacionit "Rural Credit Guarantee" më datë 11 maj 2020 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Z. Bajram Korsita
Drejtor Ekzekutiv



Znj. Besiana Lika
Specialiste e financës dhe administrimit

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 10 deri në 32, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Pasqyra e të ardhurave dhe fondeve të paspërndara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat në Lek)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i përgjithshëm	16	8,165,836	6,248,278
Te ardhura nga grantet	17	249,690	329,945
Të ardhura të tjera financiare	18	108,531,597	11,643,128
Totali i të ardhurave operative		116,947,123	18,221,351
Shpenzime personeli	21	(9,503,780)	(8,970,410)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	7, 8	(1,951,206)	(472,349)
Shpenzime të tjera operative	20	(23,868,473)	(3,969,928)
Shpenzimi për provigjone për garancitë financiare	21	(28,471,707)	(17,098,325)
Shpenzimi për provigjone për instrumentat financiarë	10	(19,764,063)	-
Totali i shpenzimeve		(83,559,229)	(30,511,012)
Humbje operative		33,387,984	(12,289,663)
Shpenzime financiare		(275,364)	-
Humbja neto nga kursi i këmbimit	22	(24,344,461)	(15,085,705)
Humbja neto nga kursi i këmbimit		(24,619,825)	(15,085,705)
Shpenzimi neto		8,768,069	(27,375,368)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Shpenzime të tjera të vitit		8,768,069	(27,375,368)

Pasqyra e të ardhurave dhe fondeve të paspërndara duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 10 deri në 32, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Pasqyra e ndryshimeve në fond më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2019

(Shumat në Lek)

	Fondi	Shpenzime të akumuluar	Totali
Gjendja më 1 janar 2018	494,716,400	(14,466,860)	480,249,540
Shpenzimi neto për vitin	-	(27,375,368)	(27,375,368)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	494,716,400	(41,842,228)	452,874,172
Gjendja më 31 dhjetor 2018			
Shpenzimi neto per vitin	3,618,731,716	-	3,618,731,716
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	8,768,069	8,768,069
Totali i të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	4,113,448,116	(33,074,160)	4,080,373,956
Gjendja më 31 dhjetor 2019			

Pasqyra e ndryshimeve në fond duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 10 deri në 32, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiar

Fondacioni Rural Credit Guarantee
Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Shumat në Lek)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Rrjedha e parasë nga aktiviteti operativ			
Shpenzimi neto për vitin		8,768,069	(27,375,368)
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	8,9	1,951,206	472,349
Amortizim i të ardhurës së shtyrë		(2,158,830)	(2,945,104)
Zhvlerësimi i garancive financiare	10,21	48,235,770	17,098,325
Diferenca nga kursi i këmbimit		296,338	15,085,705
Shpenzime interesi		275,364	-
Të ardhura nga interesi		(108,531,598)	(11,643,127)
Humbja operative përpara ndryshimeve në kapitalin punues		(51,163,681)	(9,307,220)
<i>Ndryshimet në Kapitalin Punues:</i>			
(Rritje)/Rënie në llogaritë e arkëtueshme		(4,686,778)	(391,385)
Rënie në mjete monetare të kufizuara për garanci		119,717,400	79,707,600
Rënie në të ardhurat e shtyra		10,937,713	(665,881)
Rritje në detyrime të tjera		674,629	72,818
Rritje në depozita me afat		-	(2,298,304)
Interes i paguar		(23,746,414)	-
Interes i akëtuar		89,286,910	12,416,481
Fluksi monetar gjeneruar nga / (përdorur në) aktivitetet operative		141,019,779	79,534,110
Fluksi monetar nga aktiviteti i investimit			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale		(1,312,855)	-
Investime në bono thesari		(119,228,308)	-
Investime në obligacione		(2,918,126,104)	-
Investime në depozita		(812,187,232)	-
Fluksi monetar përdorur në aktivitetin e investimit		(3,850,854,499)	-
Fluksi monetar nga aktiviteti i financimit			
Grante të marra		-	3,609,450,703
Ripagimi i qirasë		(1,571,653)	-
Kontribut nga themeluesi		3,618,731,716	-
Kapitalizim i grantit		(3,622,364,658)	-
Fluksi monetar neto nga aktiviteti i financimit		(5,204,595)	3,609,450,703
Rritje / (Rënie) neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente		(3,715,039,315)	3,688,984,812
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		3,735,361,945	46,377,133
Efekti i kursit të këmbimit në m. monetare		(296,338)	-
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në 31 dhjetor	12.1	20,026,292	3,735,361,945

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 10 deri në 32, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Fondacioni "Rural Credit Guarantee" është një organizatë jo-qeveritare jo-fitimprurëse, e themeluar nga GFA Consulting Group GmbH, një Fondacion i vendosur në Gjermani, si implementuese e fondit të grantit. Fondacioni është i regjistruar me numër regjistrimi L52004452B, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës më 8 korrik 2015.

Fondacioni "Rural Credit Guarantee" u themelua në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi Nr.7850 datë 29 qershor 1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" dhe me Ligjin Nr.8788 datë 5 qershor 2001 Për Organizatat Jo- Fitimprurëse".

Qëllimi kryesor i Fondacionit është të inkurajojë bankat dhe institucionet financiare jo-bankare që të ofrojnë shërbime financiare për mikrobizneset, bizneset e vogla dhe bizneset e mesme rurale sipas një baze të qëndrueshme për të mundësuar rritjen e tyre, për të rritur konkurrencën dhe për të krijuar më shumë vende pune.

Fondacioni bashkëpunon me banka dhe institucione financiare jo-bankare për të ofruar garanci të pjesshme për kreditë për mikrobizneset, bizneset e vogla dhe të mesme në sektorin agrar specifikisht dhe në zonat rurale në përgjithësi dhe për të zgjeruar teknologjinë e tyre agro-financiare të kreditimit, duke zhvilluar produkte dhe procedura të veçanta agrare.

Niveli më i lartë i menaxhimit është bordi i drejtorëve i përbërë si vijon:

John P. Khoury - Kryetar i Bordit
Bahrije Dibra - Anëtare e Bordit; dhe
Lauresha Grezda - Anëtare e Bordit

Përfaqësuesi i Autorizuar i Fondacionit është Drejtori Ekzekutiv, Z. Bajram Korsita.

Më 31 dhjetor 2019, Fondacioni kishte 3 punonjës (31 dhjetor 2018: 3).

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Kjo është hera e parë që Fondacioni aplikon SNRF 16 "Qiratë" në pasqyrat financiare. Ndryshimet e rëndësishme në politikat e kontabilizimit janë përshkruar në Shënimin 6.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në monedhën shqiptare Lek (LEK), që është edhe monedha funksionale dhe prezantuese e Fondacionit.

2.2 Aplikimi i standardeve të reja dhe të rishikuara

Standarde dhe Interpretime efektive për vitin aktual

Ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe i miratuar nga BE-ja, janë në fuqi për periudhën raportuese:

- **SNRF 16 "Qiratë"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshime në SNRF 9 "Instrumentet Financiare"** – Karakteristikat e Parapagimit me Kompesim Negativ (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.2 Aplikimi i standardeve të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

Standarde dhe Interpretime efektive për vitin aktual (vazhdim)

- **Ndryshime në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve"** – Ndryshimi i planit, shkurtimi ose zgjidhja (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshime në SNK 28 "Investime në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"** – Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshime në standarde të ndryshme për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2015-2017)"** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe qartësimin e formulimeve (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **KIFRN 23 "Pasigura mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),

Adoptimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të Fondacionit.

2.3 Standarde të reja dhe ndryshime në standardet ekzistuese në publikim, që nuk janë adoptuar ende

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, përmirësimet dhe interpretimet e mëposhtme janë publikuar por nuk janë akoma në fuqi.

- **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021),
- **Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit"** - Përkufizimi i një Biznesi (efektiv për kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2020 dhe për blerjet e aktiveve që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe),
- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiarë", SNK 39 "Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja" dhe SNRF 7 "Instrumentet Financiarë: Shënime Shpjeguese"** - Reforma e Normës së Interesit bazë (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2020),
Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta" - Shitja ose kontributi i aktiveve midis një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive shtyhet për një kohë të pacaktuar deri në projektin kërkimor metoda e kapitalit është përfunduar),
- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet"** - Përkufizimi i Materialit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020)
- **Ndryshimet në Referencat në Kuadrin Konceptual në Standardet e SNRF** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020),

Fondacioni ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde të reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja përpara datës kur hyjnë në fuqi.

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave të kontabilitetit dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikime në vlerësimet e kontabilitetit njihen në periudhën në të cilën vlerësimet janë rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme të prekur. Informacioni në lidhje me fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimeve kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më domethënës në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përfshirë në Shënimin 6.

Analiza e ndjeshmërisë

Drejtimi ka konsideruar një skenar standard që përfshin rritjen ose uljen me 10% të probabilitetit të falimentimit (PF) dhe humbjes së pritshme të kredisë (HPK). Analiza e ndjeshmërisë së humbjeve të mundshme të Fondacionit si rezultat i rritjes ose uljes së treguesve të humbjes së kredisë është paraqitur në tabelën më poshtë:

	PF dhe HPK	
	+10%	-10%
Zhvlerësimi më 31 dhjetor, 2019 per asetet financiare	2,047,665	(2,047,665)
Zhvlerësimi më 31 dhjetor, 2019 per asetet financiare	5,683,674	(5,683,674)
	PF dhe HPK	
	+10%	-10%
Zhvlerësimi më 31 dhjetor, 2019 per asetet financiare	-	-
Zhvlerësimi më 31 dhjetor, 2019 per asetet financiare	4,151,973	(4,151,973)

4. PARIMI I VIJUESHMËRISË

Pasqyrat financiare të Fondacionit janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë, që supozon se Fondacioni do të vazhdojë të operojë në të ardhmen e parashikueshme, mbështetur në objektivin e lëshimit të garancive financiare. Bazuar në buxhetin e aprovuar, Fondacioni planifikon të risë aktivitetin e tij operacional dhe parashikon rezultate pozitive në vitin në vijim.

Siç është paraqitur më poshtë në shënimin shpjegues 23, zhvillimi me ritme të shpejta i virusit COVID-19 dhe ndikimi i tij social dhe ekonomik në Shqipëri dhe globalisht mund të kërkojë rishikimin e supozimeve dhe vlerësimeve që mund të çojnë në rregullime materiale të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Në veçanti drejtimi pret që të ndikohen supozimet dhe vlerësimet e përdorura në përcaktimin e zhvlerësimit të aseteve financiare dhe garancive financiare në bazë të vlerës së tyre kontabël. Në këtë pikë drejtimi nuk është në gjendje të vlerësojë në mënyrë të besueshme ndikimin pasi ngjarjet po përditësohen dita-ditës. Ndikimi afatgjatë mund të prekë gjithashtu lëshimin e garancive financiare, investimet në letra me vlerë, flukset e parave dhe qëndrueshmërinë e Fondacionit.

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PARIMI I VIJUESHMËRISË (VAZHDIM)

Me 6 prill 2020, Bordi i drejtorëve i Fondacionit ka aprovuar një produkt të ri të lançuar nga Fondacioni për kompanitë e prekura nga kriza aktuale e shkaktuar nga COVID-19, që ka si qëllim të sigurojë në mënyrë të qëndrueshme akses në financim për aktivitetet e MSME-ve të ndikuara nga kjo krizë dhe nga masat e kolateralit të detyruar. Qëllimi është të kontribuojnë në ringjalljen e ekonomisë në Shqipëri dhe gjenerimin ose ruajtjen e nivelit të punësimit në sektorët prodhues, përmes ndërmjetësimit me instrumentet financiare. Mundësia e lehtësimit është e përkohshme si për klientët aktualë ashtu edhe për ato të rinj. Kjo gjë parashikohet të jetë në dispozicion deri në fund të vitit me mundësinë e zgjatjes, nëse kjo vlerësohet e nevojshme. Sidoqoftë, në datën e Pasqyrave Financiare, Fondacioni vazhdon të shlyejë detyrimet e saj brenda afateve dhe si rrjedhojë vazhdon të zbatojë parimin e vijueshmërisë në përgatitjen e pasqyrave.

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

5.1 Ndryshimet në politikat e kontabël

Fondacioni ka zbatuar fillimisht SNRF 16 "Qiratë", nga 1 janari 2019. Një sërë standardesh të tjera të reja janë gjithashtu efektive nga 1 janari 2019, por ato nuk kanë një efekt material në pasqyrat financiare të saj.

Fondacioni za SNRF 16 duke përdorur qasjen e modifikuar retrospektive, sipas së cilës efekti kumulativ i aplikimit fillestar njihet në fitimet e mbajtura në 1 Janar 2019, kur është e aplikueshme. Informacioni krahasues i paraqitur për vitin 2018 nuk riparaqitet - d.m.th. paraqitet, siç është raportuar më parë, sipas SNK 17 dhe interpretimet e ndërlidhura. Detajet mbi ndryshimet në politikat e kontabilitetit janë paraqitur më poshtë. Për më tepër, kërkesat mbi shënimet shpjeguese për SNRF 16 nuk janë zbatuar në përgjithësi për informacionin krahasues.

a. Përkufizimi i qirasë

Më parë, Fondacioni përcaktonte në fillim të kontratës nëse një marrëveshje ishte ose përbante një qira sipas KIFRN 4 "Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një Qira". Fondacioni tani vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira bazuar në përkufizimin e qirasë. Fondacioni aplikoi SNRF 16 vetëm për kontratat që janë identifikuar më parë si kontrata qiraje. Kontratat që nuk janë identifikuar si kontrata qiraje sipas SNK 17 dhe KIFRN 4, nuk janë rivlerësuar nëse ekziston një qira sipas SNRF 16. Për këtë arsye, përkufizimi i qirasë sipas SNRF 16 u aplikua vetëm për kontratat e lidhura ose të ndryshuara më ose pas 1 janarit 2019.

b. Qiramarrësi

Si qiramarrës, Fondacioni ka marrë me qira ambientet e zyrës. Fondacioni më parë klasifikonte qiratë si qira operative ose qira financiare, bazuar në vlerësimin e saj nëse qiraja transferonte në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rastësishme që vijnë nga pronësia mbi asetin. Sipas SNRF 16, Fondacioni njih të drejtën e përdorimit të asetit dhe detyrimin e qirasë për shumicën e këtyre qirave - d.m.th. këto qira janë pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar.

Me fillimin ose me modifikimin e një kontrate që përmban një komponent të qirasë, Fondacioni shpërndan vlerësimin në kontratë për secilin komponent të qirasë, bazuar në çmimin e tij të pavarur relativ.

Sidoqoftë, për qiratë e pronave, Fondacioni ka zgjedhur të mos ndajë komponentët jo-qira dhe të njohë për qiranë dhe komponentët e lidhur jo-qira si një komponent të vetëm të qirasë.

SNRF 16 nuk ka impakt në fondet e pashpërndara, përdërisa kontrata e qirasë së zyrave të saj është e vlefshme që nga 1 qershori 2019.

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

5.1 Ndryshimet në politikat e kontabël (vazhdim)

Fondacioni ka njohur të drejta shtesë të përdorimit të asetit dhe detyrime shtesë të qirasë, diferenca midis tyre është njohur në fitimin e pasqyrës. Ndikimi i kalimit në SNRF 16 është përmbledhur më poshtë.

Në Lek	1-qershor-19
E drejta e përdorimit të asetit – Ambjentet e zyrës	19,081,510
Detyrimi i qirasë	19,081,510

Për vlerësimin e detyrimeve të qirasë për qiratë që u klasifikuan si qira operative, Fondacioni skontoi pagesat e qirasë duke përdorur nivelin e saj të huamarrjes në rritje në 1 qershor 2019. Norma mesatare e ponderuar e aplikuar është 3%.

5.2 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datën e transaksionit. Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga konvertimi i transaksioneve të tilla dhe atyre në fund të vitit, njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave të pasqyrës së pozicionit financiar janë paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Euro/Lek	121.77	123.42

5.3 Aktivët afatgjatë materiale

Aktivët afatgjatë materiale janë të paraqitura me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe rënien në vlerë të akumuluar. Fitimi ose humbja neto që rrjedh nga nxjerrja jashtë përdorimit ose shitja e një aktivi afatgjatë material përcaktohet si diferencë midis të ardhurave të shitjes dhe vlerës kontabël të aktivitetit dhe njihet në pasqyrën e performancës financiare.

Shpenzimet e mëtejshme do të kapitalizohen në qoftë se do të lindin përfitime ekonomike në të ardhmen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë riparimin dhe mirëmbajtjen, njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes në momentin kur ndodhin.

Amortizimi fillon kur aktivi është në dispozicion për përdorim. Amortizimi ngarkohet në pasqyrën e fitimit ose humbjes mbi bazën e vlerës së mbetur duke përdorur normat e amortizimit si më poshtë:

Kategoria e aktivitetit	2019	2018
Mobilje dhe pajisje zyre	20%	20%
Pajisje kompjuterike	25%	25%
Programe kompjuterike	25%	25%

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

5.4 Aktivet afatgjata jo-materiale

Aktivitet jo-materiale, të cilat përbëhen tërësisht nga software, paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar, nëse ka. Amortizimi paguhet duke përdorur metodën e reduktimit të balancës. Shkalla e amortizimit e përdorur për aktivet jo-materiale është 25%. Metoda e vlerësuar e jetës së dobishme dhe e amortizimit rishikohet në fund të çdo viti raportues vjetor, me efektin e çdo ndryshimi në vlerësim që llogaritet në një bazë të ardhshme.

5.5 Aktivet financiare dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Fondacioni fillimisht njeh të arkëtueshmet financiare, depozitat dhe llogaritë investuese në datën në të cilën ato krijohen. Blerjet dhe shitjet normale të një aktivi financiar janë njohur në datën e tregtimit në të cilën Fondacioni zotohet të blejë ose të shesë aktivin. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Fondacioni bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv ose detyrim financiar është matur fillimisht me vlerën e drejtë, plus kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen apo emetimin e tij për ato aktive ose detyrime financiare që nuk mbahen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

(ii) Klasifikimi

Shih politikat kontabël 3.5; 3.6; 3.8 dhe 3.9.

(iii) Çregjistrimi

Fondacioni çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur ajo transferon aktivin financiar me një transaksion kur të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivit financiar janë transferuar, ose në ato raste kur Fondacioni as nuk ruan dhe as nuk transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar dhe nuk mban kontroll mbi aktivin financiar. Ndonjë interes mbi aktivet financiare të transferuara që plotësojnë kushtet për mosnjohje, i cili është krijuar apo përfituar nga Fondacioni njihet si një aktiv ose detyrim i veçantë.

Në çregjistrimin e një aktivi financiar, diferenca midis vlerës kontabël të aktivit (ose vlerës kontabël që i takon pjesës së transferuar të aktivit) dhe shumës së arkëtuar dhe çdo fitim apo humbje e akumuluar që është njohur në të ardhurat përmbledhëse do të njihet në fitim ose humbje.

Fondacioni merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por në të njëjtën kohë ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit të transferuar ose një pjesë të tyre. Nëse ruhen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet, atëherë aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve ku ruhen thuajse të gjitha rreziqet dhe përfitimet, përfshin për shembull huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e riblerjeve.

Në transaksionet ku Fondacioni as nuk ruan dhe as nuk transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar, Fondacioni vazhdon të njohë aktivin, në masën e përfshirjes së saj në vazhdim, që përcaktohet nga masa në të cilën ajo është e ekspozuar ndaj ndryshimit të vlerës së aktivit të transferuar.

Fondacioni çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale përfundojnë, anulohen ose i mbaron afati.

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

5.5 Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iv) Netimi

Aktivët financiarë dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe vlera e tyre neto të paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Fondacioni ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat dhe ajo synon ose të shlyejë mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten mbi baza neto vetëm kur lejohen nga SNRF-të, ose për fitime dhe humbje të lindura nga një grup transaksionesh të ngjashme si në rastin e aktiviteteve tregtare të Fondacionit.

(v) Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe shumës së maturimit, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(vi) Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet, ose një pasiv të transferohet, ndërmjet pjesëmarrësve në treg në një transaksion të zakonshëm, në datën e matjes në një treg primar ose në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm në të cilin Fondacioni ka akses në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi reflekton riskun e mosekzekutimit të tij.

Kur është e mundur, Fondacioni mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg shikohet si aktiv nëqoftëse transaksioni për një aktiv ose detyrim ndodh me një shpeshtësi dhe volum të mjaftueshëm për të siguruar informacion për çmimet në vazhdimësi. Në qoftë se për një instrument financiar nuk ka çmim në treg aktiv, Fondacioni vendos duke përdorur teknika të vlerësimit për vlerën e drejtë duke maksimizuar përdorimin e të dhënave të vëzhgueshme dhe minimizuar përdorimin e të dhënave jo të vëzhgueshme. Teknikat e zgjedhura të vlerësimit përfshijnë të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg, marrin parasysh në përcaktimin e çmimit në një transaksion.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të instrumentit financiar në njohjen fillestare, është çmimi i transaksionit, p. sh. vlera e drejtë e konsideratës së dhënë ose të marrë.

Nëse Fondacioni përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, dhe vlera e drejtë nuk është evidentuar as nga një çmimi kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose pasiv të njëjtë, as bazohet në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregje të mbikëqyruara, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, e rregulluar për të ulur diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë njihet në fitim ose humbje në baza të përshtatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet plotësisht nga të dhënat e vëzhgueshme të tregut ose transaksioni është i mbyllur.

Nëqoftëse një aktiv apo detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim oferte dhe çmim kërkesë, atëherë Fondacioni mat aktivet dhe pozicionet e gjata në çmimin e ofruar dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me një çmim të kërkuar.

Vlera e drejtë e një depozite pa afat nuk është më pak se shumës e pagueshme sipas kërkesës, skontuar nga data e parë në të cilën mund të kërkohet shumës për t'u paguar.

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Fondacioni vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar. Një humbje nga zhvlerësimi njihet për shumën me të cilën vlera kontabël e aktivit tejkalon vlerën e rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme është më e larta midis vlerës së drejtë të një aktivi minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Nuk ka pasur asnjë zhvlerësim të aktiveve jo financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019.

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

5.6 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë arkën dhe llogaritë bankare me Fondacionin.

5.7 Investime të mbajtura për të mbledhur flukset monetare kontraktuale

Investimet financiare maten fillimisht me vlerën e drejtë plus, në rastin e letrave me vlerë të investimit që nuk kanë vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, duke shtuar kostot shtesë direkte të transaksionit. Mjetet financiare të Fondacionit klasifikohen si të mbajtura për të mbledhur, sepse duke marrë parasysh modelin e tyre të biznesit ato mbahen me qëllim të grumbullimit të flukseve monetare kontraktuale; dhe kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar japin në datat të caktuara flukse të mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën e principalit të papaguar.

5.8 Balanca e Fondit

Balanca e Fondit konsiston në vlerën e drejtë të vlerave monetare të kontribuara nga themeluesi.

5.9 Të ardhura të shtyra

Të ardhurat e shtyra përfaqësojnë grantet e marra nga GFA, Ministria e Bujqësisë dhe KfW. Fillimisht ato njihen si të ardhura të shtyra.

Granti njihet si e ardhura në mënyrë sistematike gjatë periudhës në bazë të përputhjes me kostot përkatëse të cilat janë të destinuara të kompensojnë, mbi baza sistematike.

5.10 Llogari të pagueshme dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

5.11 Kontrata për garancitë financiare

Kontratat e garancisë financiare janë kontrata që kërkojnë që emetuesi të bëjë pagesa për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind sepse një debitor specifik nuk arrin të bëjë pagesat kur është e nevojshme, në përputhje me afatin e një instrumenti borxhi. Garancitë e tilla financiare u jepen bankave dhe NFBI-ve në emër të bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme në sektorin agro.

Kontratat e garancisë financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe më pas maten me vlerën më të lartë nga:

- shuma e kompensimit për humbje (llogaritur në përputhje me kërkesat e SNRF 9 për modelin e pritshëm të humbjes së kredisë); dhe
- shuma më e vogël e njohur më parë, kur është e përshtatshme, shuma kumulative e të ardhurave të njohura në përputhje me parimet e SNRF 15

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

5.12 Provigjonet për garancitë

Fondacioni siguron garanci për klientët nëpërmjet institucioneve bankare në bazë 50/50 për ndarjen e rrezikut dhe me maksimum 500,000 Euro ose ekuivalenti 60,885,000 Lek dhe garanton huamarrjet komerciale të institucioneve mikrofinanciare nga bankat vendase nën garanci të veçanta. Provigjoni për kontratat e garancisë financiare njihet kur një debitor i caktuar nuk kryen pagesat kur duhet, në përputhje me afatin e një instrumenti borxhi.

Fondacioni vlerëson në bazë të parashikimit humbjen e pritur të kredisë që lidhet me ekspozimin që rrjedh nga kontratat e garancisë financiare. Fondacioni, për humbje të tilla njih një shumë të lejuar të humbjeve, në çdo datë raportimi.

5.13 Të ardhura nga grantet

Një grant njihet në pasqyrën e pozicionit financiar fillimisht si e ardhur e shtyrë kur ka një siguri të arsyeshme që do të merret dhe Fondacioni do të permbushë kushtet bashkangjitur grantit. Grantet të cilat kompensojnë Fondacionin për shpenzimet e njohura, njihen si e ardhur në pasqyrën e fitimit ose humbjes në bazë sistematike në të njëjtën periudhë që njihen shpenzimet. Grantet që kompensojnë Fondacionin për kostot e një aktivi njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes si e ardhur në bazë sistematike mbi jetën e dobishme të një aktivi. Drejtimi vlerëson se grantet e marra kanë lidhen me shpenzimet operative të Fondacionit dhe nuk mbulojnë provigjionin dhe efektin e kursit të këmbimit.

5.14 Të ardhurat nga tarifa e disbursimit të huave

Tarifa e disbursimit të huave është njohur si e ardhur në bazë proporcionale kohore gjatë periudhës së angazhimit. Përjashtim mund të ketë vetëm në rastin e një marrëveshje specifike të huadhënies.

5.15 Të ardhura nga interesat e huave të garantuara

E ardhura nga interesi i garancisë së huasë njihet në bazë të proporcionit kohor që merr parasysh metodën e normës efektive të interesit.

5.16 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes sipas shfrytëzimit të shërbimit.

5.17 Përfitimet e punonjësve

Detyrimet për kontributet e përcaktuara të planeve të pensionit njihen si shpenzime në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse kur ato ndodhin. Fondacioni paguan vetëm kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqerore të cilat sigurojnë përfitime kur punonjësit arrijnë moshën e pensionit. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për sigurimin e një niveli minimal pensioni sipas një plani të përcaktuar të kontributeve.

Në 12 janar 2019, Fondacioni ka nënshkruar një marrëveshje me Sigal Uniqa Group Austria lidhur me një anëtarësim në fondin vullnetar të pensionit, ku Fondacioni do të kontribuojë së bashku me punonjësit e tij. Në 1 nëntor 2019, Fondacioni nënshkroi një kontratë me Sigal Uniqa Group Austri për sigurimin shëndetësor privat për punonjësit, ku Fondacioni paguan një prim vjetor sigurimi. Polica e sigurimit shëndetësor privat rimbursion shpenzimet mjekësore nën një listë të veçantë të përfitimeve dhe një kufi maksimal vjetor me zonën e mbulimit: spitale private në Shqipëri dhe Europë.

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

5.18 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Fondacioni Rural Credit Guarantee është themeluar si një organizatë jo-fitimprurëse dhe për këtë arsye, sipas rregullores për organizatat jo-fitimprurëse në Shqipëri, është i përjashtuar nga tatimi mbi fitimin. Megjithatë, Fondacioni do të paguajë tatimin mbi fitimin për fitimet nga investimet, por jo për fitimin operativ.

6. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

6.1 Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë, është rreziku i humbjes financiare së Fondacionit, nëse një klient ose një palë tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale, dhe vjen kryesisht nga depozitat bankare të Fondacionit, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre.

Rreziku i kredisë për mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre konsiderohet i papërfillshëm, pasi kundërpartitë janë Fondacione me reputacion.

Ekspozimi maksimal i Fondacionit ndaj rrezikut të kredisë, përfaqësohet nga vlera kontabël e çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar, e paraqitur në tabelën më poshtë (shumat paraqiten në Lek):

<i>Klasat e aktiveve financiare – vlerat e mbetura</i>	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	20,026,292	3,855,079,345
Depozita afatshkurtra -BKT	793,534,613	-
Depozita afatshkurtra -Fibank	60,885,000	-
Depozita afatshkurtra –Union Bank	60,885,000	-
Depozita afatshkurtra – Credins Bank	-	103,238,904
Investime të mbajtura për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale	3,270,634,502	209,258,314
Vlera Kontabël	4,205,965,407	4,167,576,563

Tabela mëposhtë paraqet ekspozimin e riskut e kredisë ndaj kundërpasive dhe falimentimit apo zhvlerësimeve të lidhura, nëse ka:

Investimet ne Letra me vlerë	Qeveria Shqiptare	Totali
Më 31 dhjetor 2019		
As në vonesë dhe as të zhvlerësuara	-	-
Jo në vonesë, por të zhvlerësuara sipas kërkesave të SNRF 9	3,270,634,502	3,270,634,502
Të zhvlerësuara	(19,764,063)	(19,764,063)
Total	3,250,870,439	3,250,870,439
Më 31 dhjetor 2018		
As në vonesë dhe as të zhvlerësuara	-	-
Jo në vonesë, por të zhvlerësuara sipas kërkesave të SNRF 9	209,258,314	209,258,314
Të zhvlerësuara	-	-
Total	209,258,314	209,258,314

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

6. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**6.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)**

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre	Banka të Nivelit të Dytë	Totali
<i>Më 31 dhjetor 2019</i>		
As në vonesë dhe as të zhvlerësuara	20,026,292	20,026,292
Jo në vonesë, por të zhvlerësuara sipas kërkesave të SNRF 9	-	-
Total	20,026,292	20,026,292

<i>Më 31 dhjetor 2018</i>		
As në vonesë dhe as të zhvlerësuara	3,855,079,345	3,855,079,345
Jo në vonesë, por të zhvlerësuara sipas kërkesave të SNRF 9	-	-
Total	3,855,079,345	3,855,079,345

Depozitat me afat	Banka të Nivelit të Dytë	Totali
<i>Më 31 dhjetor 2019</i>		
As në vonesë dhe as të zhvlerësuara	915,304,613	915,304,613
Jo në vonesë, por të zhvlerësuara sipas kërkesave të SNRF 9	-	-
Total	915,304,613	915,304,613

<i>Më 31 dhjetor 2018</i>		
As në vonesë dhe as të zhvlerësuara	100,000,000	100,000,000
Jo në vonesë, por të zhvlerësuara sipas kërkesave të SNRF 9	-	-
Total	100,000,000	100,000,000

Fondacioni përdor vlerësimet e kredive të publikuara në agjensitë ndërkombëtare të vlerësimit të kredisë për të përllogaritur probabilitetet e mospagimit të aktiveve dhe detyrimeve financiare e detajuar si më poshtë:

Vlerësimi sipas Moody's për 2019	Institucioni	Probabiliteti i mospagimit
B+	Qeveria e Shqipërisë	1.06%
B+	Banka e Shqipërisë	1.06%
Nuk është publikuar vlerësim	Credins Bank	-
Nuk është publikuar vlerësim	Banka Kombëtare Tregtare	-

Vlerësimi sipas Moody's për 2018	Institucioni	Probabiliteti i mospagimit
B+	Qeveria e Shqipërisë	0.69%
B+	Banka e Shqipërisë	0.69%
Nuk është publikuar vlerësim	Credins Bank	-
Nuk është publikuar vlerësim	Banka Kombëtare Tregtare	-

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

*(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***6. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****6.2 Rreziku i likuiditetit**

Manaxhimi i kujdesshëm i rrezikut të likuiditetit, nënkupton mbajtjen e mjeteve monetare të mjaftueshme dhe disponueshmërinë e fondeve të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të Fondacionit në momentin që ato duhet të shlyhen.

Tabelat e mëposhtme paraqesin maturimet e mbetura kontraktuale të detyrimeve financiare të Fondacionit më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018.

Më 31 dhjetor 2019

	Vlera kontabël neto	3 muaj ose më pak	3-12 muaj	1-10 vite
Aktive Financiare				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	20,026,292	20,026,292	-	-
Depozita	915,426,135	915,426,135	-	-
Llogari të arkëtueshme	6,175,148	6,175,148	-	-
Investime të mbajtura për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale	3,270,634,502	-	225,347,672	3,045,286,830
	4,212,262,078	941,627,575	225,347,672	3,045,286,830
Detyrime Financiare				
Detyrime të tjera	1,206,860	1,206,860	-	-
Detyrime të qirasë	17,409,857	-	2,282,272	15,227,585
Detyrime të kushtëzuara	1,421,014,125	-	1,421,014,125	-
	1,439,730,842	1,206,860	1,423,296,397	15,227,585
Ekspozimi Neto	2,772,531,236	940,420,716	(1,197,948,725)	3,030,059,245

Kërkesat e likuiditetit për të mbështetur thirrjet nën garanci financiare janë dukshëm më pak se shuma e angazhimit të shpalosur në analizën e mësipërme të maturimit, sepse Fondacioni zakonisht nuk pret që pala e tretë të tërheq fonde në bazë të marrëveshjes. Shuma totale e detyrimeve kontraktuale të zotimeve për të përdorur garancitë financiare të përfshira në tabelën e pjekurisë së mësipërme nga 3 deri në 12 muaj nuk paraqet domosdoshmërisht kërkesat e ardhshme të parave të gatshme, pasi shumë nga këto angazhime do të skadojnë ose përfundojnë pa u financuar.

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

6. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)
6.2 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)
Më 31 dhjetor 2018

	Vlera kontabël neto	3 muaj ose më pak	3-12 muaj	1-10 vite
Aktive Financiare				
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	3,855,079,345	3,735,361,945	119,717,400	-
Depozita afatshkurtra	103,238,904	-	-	103,238,904
Llogari të arkëtueshme	1,488,371	1,488,371	-	-
Investime të mbajtura deri në maturim – Bono thesari	209,258,314	-	-	209,258,314
	4,169,064,934	3,736,850,316	119,717,400	312,497,218
Detyrime Financiare				
Detyrime të tjera	532,231	532,231	-	-
Detyrime të kushtëzuara	459,618,055	-	459,618,055	-
	460,150,286	532,231	459,618,055	-
Ekspozimi Neto	3,708,914,648	3,736,318,085	(339,900,655)	312,497,218

7. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2019 përbëhen si më poshtë:

	Mobilje zyre dhe pajisje	Pajisje Kompjuterike	Totali
Kosto			
Më 1 janar 2018	629,538	700,077	1,329,615
Shtesa	-	-	-
Më 31 dhjetor 2018	629,538	700,077	1,329,615
Shtesa	607,495	705,360	1,322,855
Më 31 dhjetor 2019	1,247,033	1,405,437	2,652,470
Zhvlerësim i akumuluar			
Më 1 janar 2018	(236,018)	(256,847)	(492,865)
Zhvlerësim për vitin	(78,703)	(110,798)	(189,501)
Më 31 dhjetor 2018	(314,721)	(367,645)	(682,366)
Zhvlerësim për vitin	(134,036)	(137,225)	(271,261)
Më 31 dhjetor 2019	(448,757)	(504,870)	(953,627)
Vlera kontabël neto			
Më 31 dhjetor 2018	314,817	332,432	647,249
Më 31 dhjetor 2019	798,276	900,567	1,698,853

Aktivet afatgjata materiale nuk janë vendosur si kolateral ndaj palëve të treta më 31 dhjetor 2019 (2018: asnjë).

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

*(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***8. AKTIVE JO MATERIALE**

Aktivet jo materiale përbëhen si më poshtë:

	Programe kompjuterike	Totali
Kosto		
Më 1 janar 2018	1,616,200	1,616,200
Shtesa	-	-
Më 31 dhjetor 2018	1,616,200	1,616,200
Shtesa	-	-
Më 31 dhjetor 2019	1,616,200	1,616,200
Amortizimi akumuluar		
Më 1 janar 2018	(484,808)	(484,808)
Amortizimi për vitin	(282,848)	(282,848)
Më 31 dhjetor 2018	(767,656)	(767,656)
Amortizimi për vitin	(212,136)	(212,136)
Më 31 dhjetor 2019	(979,792)	(979,792)
Vlera e mbetur		
Më 31 dhjetor 2018	848,544	848,544
Më 31 dhjetor 2019	636,408	636,408

9. E DREJTA E PËRDORIMIT TË ASETETEVE

E drejta e përdorimit të asetëve më 31 dhjetor 2019 është detajuar si më poshtë:

(a) Shiko Shënimin 7 (h).

	Ndërtesa	Totali
Kosto		
Gjendja më 1 Janar 2019 në aplikimin fillestar të SNRF 16	-	-
Amortizimi për vitin	-	-
Shtesa në të drejtën e përdorimit të asetëve	19,081,510	19,081,510
Amortizimi për vitin	(1,467,808)	(1,467,808)
Mosnjohja e të drejtës së përdorimit	-	-
Më 31 Dhjetor 2019	17,613,702	17,613,702

(b) Shumat e njohura në fitim ose humbje janë paraqitur më poshtë:

Shumat e njohura në fitim ose humbje dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse 2019 - Qira sipas SNRF 16	Në Lek
Amortizimi për të drejtën e përdorimit të asetëve (shiko (a))	1,467,809
Shpenzime interesi për detyrimin e qirasë	275,364

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

*(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***10. INVESTIME TË MBAJTURA PËR MBLEDHJEN E FLUKSEVE MONETARE KONTRAKTUALE****10.1 Bono thesari**

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Bono thesari	120,000,000	-
Zbritje nga bono thesari	(1,652,328)	-
Interes i akumuluar	880,636	-
Totali	119,228,308	-

Gjatë vitit 2019, Fondacioni bleu një bono thesari me zbritje dhe një vlerë nominale 120,000,000 lekë, kupon me vlerën fikse - 1.4%, për tu maturuar pas një viti, më 18 qershor 2020.

10.2 Obligacione thesari

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Obligacione	3,130,350,000	207,000,000
Zbritje - Obligacione	(9,241,805)	-
Prim - Obligacione	2,431,559	-
Prim - Eurobonde	11,025,825	-
Interes i akumuluar - Obligacione	22,107,062	2,258,314
Interes i akumuluar - Eurobonde	14,497,616	-
Totali	3,171,170,257	209,258,314
Provizione për instrumentat financiarë	(19,764,063)	-
Vlera kontabil totale	3,151,406,194	209,258,314

Gjatë vitit 2019 Fondacioni realizoi investime të reja në obligacione në lekë dhe euro. Obligacionet e thesarit kanë kupon me normë fikse 5.85% për t'u maturuar në 10 vjet; 1.45% për t'u maturuar në 2 vjet dhe kupon me normë fikse - 3.75% për t'u maturuar në 7 vjet dhe 5.53% për tu pjekur në 10 vjet. Dy investimet e tjera të obligacionit janë në euro (Eurobonde), me vlerë nominale 10,000,000 EUR, dhe 5,000,000 EUR, të dy me kupon me vlerë fikse - 3.5% për t'u maturuar në 7 vjet. Për blerjen e obligacioneve të thesarit, Fondacioni pagoi një interes prej 22,107.062 lekësh në lidhje me interesin e krijuar nga data e emetimit të letrave me vlerë deri në datën e blerjes. Fondacioni do të marrë interesin e plotë në datën e ardhshme të kuponit, i cili do të përfshijë shumën e paguar dhe të ardhurat nga interesi nga data e blerjes deri në datën e kuponit.

2019**Stage sipas Expected Loss për Asetet Financiare**

	Stage 1	Stage 2	Stage 3	Totali
Investime	3,290,398,565	-	-	3,290,398,565
Shuma bruto	3,290,398,565	-	-	3,290,398,565
Provizione	(19,764,063)	-	-	(19,764,063)
Shuma neto	3,270,634,502	-	-	3,270,634,502

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

*(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***10. INVESTIME TË MBAJTURA PËR MBLEDHJEN E FLUKSEVE MONETARE KONTRAKTUALE (VAZHDIM)****10.2 Bono thesari (vazhdim)**

	2018			
	Stage sipas Expected Loss për Asetet Financiare			
	Stage 1	Stage 2	Stage 3	Totali
Investime	209,258,314	-	-	209,258,314
Shuma bruto	209,258,314	-	-	209,258,314
Provigjone	-	-	-	-
Shuma neto	209,258,314	-	-	209,258,314

11. LLOGARITË E ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Afatshkurtra		
Të arkëtueshme nga Mikrofinancat	1,120,180	525,419
Të arkëtueshme nga Bankat	4,725,848	908,179
Parapagime	329,120	54,774
Nën totali	6,175,148	1,488,372
Afatgjata		
Parapagime	1,078,728	-
Nën totali	1,078,728	-
Totali	7,253,876	1,488,372

Llogaritë e arkëtueshme në 31 dhjetor 2019 përfaqësojnë shumat e papaguara nga Bankat dhe Institucionet Mikro – Financiare lidhur me interesat dhe tarifat e disbursimit për tre mujorin e katërt të vitit.

12. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTE TË TYRE**12.1 Mjete monetare në arkë dhe në bankë**

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre përbëhen si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2019	Më 31 Dhjetor 2018
Mjete monetare në bankë në Lek	19,049,120	36,455,322
Mjete monëare në bankë në Euro	968,562	3,698,903,153
Mjete monetare në arkë	8,610	3,470
Totali	20,026,292	3,735,361,945
Mjete monetare të bllokuara në bankë	-	119,717,400
Totali mjete monetare në arkë dhe bankë	20,026,292	3,855,079,345

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

12. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTE TË TYRE (VAZHDIM)

12.1 Mjete monetare në arkë dhe në bankë (vazhdim)

Më 31 Dhjetor 2019 mjetet monetare në bankë përfshijnë llogari rrjedhëse të mbajtura në BKT, Credins Bank, Union Bank dhe Fibank.

Fondacioni ka përdorur mjetet monetare të bllokuara në investimin e bonove të thesarit, bonove, eurobonove dhe depozitave afatshkurtra siç përshkruhet në shënimin 6 dhe 8. Ndërsa më 31 dhjetor 2019, mjetet monetare të bllokuara janë zero (31 dhjetor 2018: 970,000 EUR ose ekuivalent në 119,717,400 lekë, me kursin e këmbimit lekë / 123.42 EUR).

12.2 Depozita afatshkurtër

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Depozita me afat	915,304,614	100,000,000
Interesi i përllogaritur	121,522	3,238,904
Totali	915,426,136	103,238,904

Gjatë vitit 2019, RCGF nënshkroi katër marrëveshje afatshkurtra të depozitave me BKT ekuivalent me 793,534,613 lekë me detajet e mëposhtme:

- 40,000,000 lekë, depozitë 1 muaj me normë interesi 0.3% dhe data e maturimit në 15 Janar 2020;
- 3,000,000 EUR, depozitë 1 muaj me normë interesi 0,05% dhe data e maturimit më 8 Janar 2020, e rinvestuar çdo muaj nga 7 Qershor 2019;
- 2,948,179 EUR, depozitë 1 muaj me normë interesi 0,05% dhe data e maturimit, më 16 janar 2020;
- 240,000 EUR, depozitë 1 muaj me normë interesi 0,05% dhe data e maturimit më 15 janar 2020.

Gjithashtu, RCGF hyri në dy marrëveshje të tjera afatshkurtra të depozitave me Fibank dhe Union Bank nga 500,000 EUR secila, përkatësisht me normën e interesit 0.2%, datën e maturimit në 20 Janar 2020 dhe me normën e interesit 0.1%, datën e maturimit në 20 Janar 2020.

13. TË ARDHURA TË SHTYRA

Ka dy lloje të ardhura të shtyra:

Nga grantet - Një grant njihet në pasqyrën e pozicionit financiar fillimisht si e ardhur e shtyrë kur ekziston një siguri e arsyeshme se ajo do të merret dhe se Fondacioni do të jetë në përputhje me kushtet lidhur me të. Më 20 maj 2019, Bordi i Drejtorëve vendosi të rrisë kapitalin me fonde nga Grantet e marra nga KfW për një shumë të barabartë me 3,618,731,716 lek.

Nga tarifat e disbursimit – tarifa e disbursimit është një tarifë që paguhet njeherë dhe përllogaritet mbi shumën e garantuar të kredisë në momentin kur disbursohet kredia.

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

*(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***13. TË ARDHURA TË SHTYRA (VAZHDIM)**

Më 31 dhjetor 2019 të ardhurat e shtyra janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Pjesa afatshkurtër		
Tarifa e disbursimit	3,987,085	216,742
Grante nga GFA	242,630	320,532
Grante nga dega GFA-së në Shqipëri	7,060	9,413
	4,236,775	546,687
Pjesa afatgjatë		
Tarifa e disbursimit	7,842,053	424,994
Grante nga GFA	519,312	684,040
Grante nga dega GFA-së në Shqipëri	14,715	19,422
Grante afatgjata nga Ministria e Bujqësisë	62,765,278	62,765,278
Grante nga KfW	-	3,622,364,658
	71,141,358	3,686,258,392
Totali	75,378,133	3,686,805,079

14. DETYRIMI PËR QIRANË

Termat dhe kushtet e detyrimeve të papaguara të qirasë më 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë:

	Monedha	Norma e huamarrjes	Vitet e maturimit	Pagesa minimale mujore e qirasë	
				Në Monedhë	Në Lek ('000)
Detyrimi i qirasë	EUR	3.00%	2019-2026	1,900	231,363

Më poshtë janë paraqitur flukset monetare të paskontuara për shlyerjet e detyrimeve të qirasë sipas vitit të maturimit:

	31 Dhjetor 2019
- Më pak së një vit	-
- Midis një dhe dy vitesh	-
- Midis dy dhe tre vitesh	-
- Midis tre dhe katër vitesh	-
- Midis katër dhe pesë vitesh	-
- Më shume se pesë vite	19,434,492
	19,434,492
Minus shpenzime interesi të shtyra	(1,924,635)
Detyrimi për qira financiare	17,509,857

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

*(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***15. DETYRIME TË TJERA**

Detyrimet e tjera përbëhen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Tatim mbi të ardhurat personale	98,002	95,170
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	81,226	75,780
Kreditorë / furnitorë lokalë	187,621	10,060
Tatim në burim	706	12,676
Interes i përlogaritur	839,305	338,545
Totali	1,206,860	532,231

16. TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I PËRGJITHSHËM

Të ardhurat nga aktiviteti i përgjithshëm përfaqësojnë të ardhura nga tarifat e disbursimit dhe të interesit, të cilat fitohen nga aktiviteti kryesor i Fondacionit - duke i ofruar garanci për Institucionet Financiare Partnere. Llogaria përbëhet nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga interesi nga bankat	2,919,948	2,151,688
Të ardhura nga interesi nga Mikrofinancat	3,087,022	1,489,406
Të ardhura nga tarifa e disbursimit nga Mikrofinancat	1,492,453	1,485,150
Të ardhura nga tarifa e disbursimit nga bankat	666,413	1,122,034
Totali	8,165,836	6,248,278

Fondacioni fiton nga Institucionet e Mikro Financimit 0.75% interesa cdo vit mbi mesataren ditore të balancës së mbetur. E ardhura e interesit nga bankat llogaritet si përqindje (specifikuar në kontratë) mbi mesataren e balancës së mbetur së tre – mujorit.

Tarifa e disbursimit është një tarifë e vetme e përlogaritur mbi vlerën e huasë së garantuar dhe merret kur huaja disbursohet. Tarifat e disbursimit regjistrohen fillimisht si të ardhura të shtyra dhe më pas njihen si të ardhura ose shpenzime përgjatë maturimit të huasë së garantuar.

17. TË ARDHURA NGA DONACIONET

Të ardhurat nga grantet përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga donacioni – Zhvlerësimi i aktiveve të dhuruara nga GFA	249,690	329,945
Totali	249,690	329,945

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

*(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***18. TË ARDHURA TË TJERA FINANCIARE**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë të investimit	106,640,610	9,339,000
Të ardhura nga interesat e depozitave	1,890,987	2,304,128
Total	108,531,597	11,643,128

Zëri të ardhura të tjera financiare përbëhet kryesisht nga të ardhura nga interesat e investimeve në bono thesari, obligacione thesari dhe depozita bankare.

19. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Paga bruto	8,520,120	8,050,000
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	557,654	517,910
Sigurime suplementare	426,006	402,500
Totali	9,503,780	8,970,410

20. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE

Shpenzime të tjera operative përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Komisione bankare për kujdestari të investimeve	9,325,000	50,000
Pagesë Claim	7,036,125	-
Tatim në burim	4,334,970	1,549,315
Shpenzime Auditimi	1,379,950	418,065
Mirëmbajtje dhe furnizime për zyrën	499,466	411,259
Shpenzime sigurimi	283,617	195,127
Qira	253,700	780,371
Konsulencë fiskale	182,655	-
Shpenzime transporti	130,891	78,272
Postë dhe komunikim	122,327	127,256
Komisione bankare	83,688	27,945
Utilitete	79,829	87,800
Sigurim shëndeti	45,510	-
Taksa lokale	15,000	15,000
Shpenzime të tjera	95,745	229,518
Totali	23,868,473	3,969,928

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

20. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE (VAZHDIM)

Komisionet bankare për kujdestarinë e investimeve kanë të bëjnë me shpenzimet e ngarkuara nga banka kujdestare e titullit financiar (bono thesari, obligacione, eurobonde të Qeverisë Shqiptare), kryesisht pjesa më e madhe përbëhet nga komision 0,5% për të ardhurat nga eurobonove. Tatimi në burim përfaqëson 15% të të ardhurave nga interesi të fituara nga investimet në letra me vlerë.

Me 31 Dhjetor 2019, pagesa e claim për kreditë e garantuara 7,036,125 lekë (2018: zero) përfaqëson pagesa të Fondacionit për 2 klientë të Credins Bank dhe 4 klientë të BKT me më shumë se 180 ditë vonesa, duke mbuluar 50% të tepricave të ekspozimit sipas marrëveshjes kontraktuale me bankën. Garancitë e paracaktuara për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019 janë dhënë në vitin e kaluar në shumën 3,858,818 lekë; shiko Shënimin 21.

21. PROVIJONE PËR GARANCI

Lëvizja në shpenzimet e provigjionit për garancitë ndaj bankave dhe institucioneve mikro financiare është si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Më 1 janar	30,349,246	13,250,921
Garancitë financiare të humbura	(3,858,818)	-
Rimarrje provigjioni për vitin	(5,523,705)	(1,011,410)
Shpenzim provigjioni për vitin	37,854,230	18,109,735
Shpenzim provigjioni për vitin, neto	<u>28,471,707</u>	<u>17,098,325</u>
Më 31 Dhjetor	<u>58,820,953</u>	<u>30,349,246</u>

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019, ka një rritje në shpenzimin e provigjionit, i cili lidhet drejtëpërdrejtë me zhvlerësimin e vlerës së llogaritur nga BKT dhe Credins Bank dhe përqindja e huave jo – performuese gjatë tre viteve të fundit nga NOA, FedInvest dhe Fondi Besa.

22. HUMBJE NETO NGA KURSI I KËMBIMIT

Llogaria përbëhet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Gain from foreign exchange rate	18,231,069	8,950,377
Loss from foreign exchange rate	(42,575,530)	(24,036,082)
Losses from foreign exchange translations, net	<u>(24,344,461)</u>	<u>(15,085,705)</u>

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

*(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***23. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA**

Më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 Fondacioni nuk ka pretendime ligjore kundër tij në rrjedhën normale të biznesit.

Detyrimet e kushtëzuara më 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2019		Më 31 Dhjetor 2018	
	Vlera e mbetur	Vlera e disbursuar e garantuar	Vlera e mbetur	Vlera e disbursuar e garantuar
Detyrimet e kushtëzuara				
Garanci ndaj NOAs	435,000,000	435,000,000	152,354,347	154,275,000
Garanci ndaj FedInvestit	331,825,000	375,800,000	149,839,266	154,275,000
Garanci ndaj Unifin	0	23,000,000	-	-
Garanci ndaj Fondi Besa	405,495,000	405,495,000	-	-
Garanci ndaj klientëve të Credins Bank	154,701,216	227,878,907	61,254,863	99,292,650
Garanci ndaj klientëve të BKT	93,992,909	164,452,520	96,169,579	122,822,521
Totali	1,421,014,125	1,631,626,427	459,618,055	530,665,171

Fondacioni jep garanci për klientët nëpërmjet institucioneve bankare në baza ndarje risku 50/50 dhe me limit maksimal deri në 500,000 Euro për Dritaren e Rregullt dhe 2500,000 Euro për Dritaren e Gjelbërt dhe garanton huamarrjet tregtare të institucioneve mikrofinanciare nga bankat lokale nën garanci të veçanta.

Vlera e mbetur lidhet me vlerën e mbetur të huave të garantuara nga Fondacioni.

Vlera e disbursuar e garantuar lidhet me vlerën e garantuar të huave të disbursuara, që është 50% e vlerës totale të disbursuar për institucionet bankare dhe 100% e vlerave të disbursuara për institucionet e mikro financimit.

24. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA

Një palë është e lidhur me një entitet nëse, direkt ose indirekt përmes një ose më shumë ndërmjetësve, pala kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike, pala ka një interes në njësinë ekonomike që i jep ndikim të rëndësishëm mbi entitet, pala ka kontroll të përbashkët mbi njësinë ekonomike, pala është një pjesëmarrje ose pala është një anëtar i personelit drejtues kryesor të njësisë ekonomike ose mëmës së tij.

Transaksionet me palët e lidhura përbëjnë:

	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Grantet afatgjata nga KFW	-	3,622,364,658
Grantet afatgjata nga GFA	519,312	684,040
Grantet afatgjata nga dega e GFA-së në Shqipëri	14,715	19,422

Fondacioni Rural Credit Guarantee

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

*(Shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***24. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura		
Të ardhura nga grantet – Zhvlerësimi i asetëve	249,690	329,945
Totali	249,690	329,945

Kompensimi i Manaxhimit

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Kompensim afatshkurtër		
Paga	4,575,720	4,310,000
Totali	4,575,720	4,310,000

25. NGJARJE PAS DATES SË RAPORTIMIT FINANCIAR

Në Dhjetor 2019, një shpërthim i një lloji të ri të koronavirusit, COVID-19, u shfaq në Wuhan, Kinë. Brenda disa javësh, pavarësisht përpjekjeve për të izoluar virusin në Kinë që përfshinte mbyllje të gjerë të qyteteve dhe bizneseve, numri i të infektuarve u rrit ndjeshëm, dhe përtej kufijve të Kinës, përfshirë Shqipërinë. Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit njoftoi një situatë pandemie për shkak të emergjencës globale të shkaktuar nga shpërthimi i COVID 19. Përhapja e koronavirusit ende po evoluon dhe efektet e saj mbeten të panjohura. Për detaje të mëtejshme, ju lutemi referojuni Shënimit 4 "Shqetësimi i Vijimit".

Me 4 shkurt 2020, Fondacioni nënshkroi një kontratë investimi me Union Bank në lidhje me një depozitë 25 – mujore me vlerë 60,850,000 Lekë, me interes vjetor prej 2.25%, e cila maturohet më 4 mars 2022.

Për më tepër, më 20 mars 2020, Fondacioni ka çelur një tjetër depozitë në Union Bank në vlerën 60,990,000 Lekë, me interes vjetor prej 2.1% , e cila maturohet më 20 mars 2021.

Gjithashtu, gjatë periudhës janar – prill 2020 u kryen këto investime në bono thesari :

- Në 10 shkurt 2020, investim në obligacion qeveritar 2-vjeçar nëpërmjet Fibank, në vlerën 60,300,000 Lekë në tregun primar, me normë kuponit 2.25%, yield 2.2% , emetuar më 10 janar 2020 dhe maturim më datë 10 janar 2022.

- Në 13 mars 2020, investim në obligacion qeveritar 7-vjeçar nëpërmjet Fibank, në vlerën 61,000,000 Lekë në tregun primar, me normë kuponit 4.08%, me datë maturiteti 13 mars 2027.

- Në 13 mars 2020, investim në obligacion qeveritar 7-vjeçar nëpërmjet bankës OTP, në vlerën 123,400,000 Lekë në tregun primar, me normë kuponit 4.08%, me datë maturiteti 13 mars 2027.

- Në 21 prill 2020, investim në obligacion qeveritar 2-vjeçar nëpërmjet BKT, në vlerën 107,000,000 Lekë në tregun primar, me normë kuponit 2.55%, me datë maturiteti 21 prill 2022.

Në lidhje me Garancitë e Huave:

- Në 23 janar 2020, RCGF nënshkroi një marrëveshje partneriteti me bankën OTP për implementimin e "Rural Credit Guarantee Facility", siç është nënshkruar dhe me institucionet financiare të tjera partnere.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit për të cilat nevojiten rregullime apo shënime shpjeguese në këto pasqyra financiare.